



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency

011/1407/22
30-9-2022

Pranuar me Primjeto:	30.09.2022	
Njësia Jednica:	Numri E-:	Shtojca Dodatak
1-660/03-52813		

MEMORANDUMI I BASHKËPUNIMIT (MB)

Ndërmjet

AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS

dhe

KOMUNËS SË LIPJANIT

për

KOMPLETIMIN E SISTEMIT TË ADRESAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS

Ky MM rregullon bashkëpunimin ndërmjet palëve të mësipërme për zbatimin e një projekti për plotësimin e sistemit të adresave në territorin e Komunës.

Zbatimi i sistemit të ri të adresave në Kosovë është duke u zhvilluar mirë. Të gjithë qytetarët, bizneset dhe institucionet publike duhet të kenë një adresë unike, i cili regjistrohet në regjistrin shtetëror të adresave dhe shënohet në terren. Aktivitetet e realizuara bashkërisht nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), projekti i financuar nga BE-ja "Mbështetje për Agjencinë e Regjistrimit Civil dhe Sistemin e Unifikuar të Adresave", Autoriteti Norvegjez Hartografik (SK) dhe komunat, kanë bërë që të arrihen rezultate të mira. Korniza legjislative, e përbërë nga Ligji dhe udhëzimet administrative, është vendosur, ndër të tjera, që mbulon mirëmbajtjen e të dhënave të adresës, shpërndarjen e të dhënave të adresës, përdorimin e të dhënave të adresës dhe specifikimet teknike për prodhimin e shenjave të adresës dhe metodologjinë për instalimin e tabelave. Sistemi i Informacionit të Regjistrit të Adresave (ARIS) është zhvilluar dhe është në përdorim si Regjistër Shtetëror i Adresave. Hapat e ardhshëm për kompletimin e sistemit të adresave për Kosovën janë grumbullimi i të dhënave të adresave për përditësimin e Regjistrit të Adresave dhe prodhimi dhe instalimi i shenjave të emrave të rrugëve dhe shenjave të numrave të adresave në komunat ku sistemi i adresave deri më tani nuk është kompletuar. Më pas, të dhënat zyrtare të adresës duhet, ndër të tjera, të përdoren nga Regjistri i Gjendjes Civile dhe nga sistemet e navigimit të veturave për Kosovën.

Kompletimi i sistemit të adresave në Kosovë, do të bëhet në bashkëpunim të përbashkët të AKK-së dhe komunave, të mbështetur nga "Projekti i Kadastrës së Patundshmërive dhe Infrastrukturës Gjeohapësimore" (REGIP) të Bankës Botërore.

Komunat, të monitoruara nga AKK, do të jenë palët e përgjithshme përgjegjëse për kompletimin e sistemit të adresave në territoret e tyre përkatëse. Duke pasur parasysh se Komuna e Lipjanit (në tekstin e mëtejshëm "Komuna") ka përgjegjësinë për vendosjen e adresave në territorin e saj sipas ligjit nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, i ndihmuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK).



Më tej duke pasur parasysh se sistemi i adresave në komunë nuk është i kompletuar, përditësuar dhe mirëmbajtur.

Më tej duke pasur parasysh se Banka Botërore, përmes projektit REGIP, ka aprovuar projekt propozimin e bërë nga AKK.

Duke marrë parasysh objektivin e përbashkët për të krijuar një sistem të unifikuar adresash në Kosovë dhe për të siguruar përdorimin më të gjerë të tij nga njerëzit, bizneset dhe institucionet publike në Kosovë përmes kompletimit të sistemit të adresave, AKK dhe Komuna kanë rënë dakord që të hyjnë në këtë Memorandum të Bashkëpunimit për të krijuar një ndarje të qartë të përgjegjësi drejt arritjes së objektivave të lartpërmendura.

Duke respektuar më tej se rrugët dhe objektet e adresueshme duhet të shënohen me emrin dhe numrin e tyre, çdo emër dhe numër adrese duhet të sinjalizohet dhe çdo qytetar dhe biznes duhet të informohet dhe të pajiset me adresën e tij zyrtare dhe unike.

Së fundi, duke vërejtur se operatorët do të kontraktohen për të realizuar objektivat për plotësimin dhe përdorimin e Sistemit të Adresave,

Palët janë pajtuar si më poshtë:

[Agjencia Kadastrale e Kosovës]

1. AKK do t'i kryej detyrat e saj sipas Ligjit nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave;
2. AKK-ja do t'i ofrojë komunës udhëzimin e përgjithshëm metodologjik për përditësimin, mirëmbajtjen, përdorimin e të dhënave të adresave dhe/ose sinjalizimin e emrave të rrugëve dhe/ose numrave të adresave, në përputhje me Ligjin për Sistemin e Adresave dhe Udhëzimet Administrative në fuqi;
3. AKK do të zhvillojë procedurat e prokurimit për projektin e Kompletimit të Sistemit të Adresave në kuadër të projektit REGIP, bazuar në rregulloret e Bankës Botërore;
4. AKK do të përgatis specifikat teknike të nevojshme për projektin e Kompletimit të Sistemit të Adresave në kuadër të projektit REGIP;
5. AKK-ja do t'i ofrojë asistencë teknike Komunës, duke përfshirë, por pa u kufizuar në ekspertizën, trajnimin dhe aktivitetet e tjera të nevojshme për ngritjen e kapaciteteve për të mbështetur kompletimin dhe përdorimin e sistemit të adresave;
6. AKK do të asistoj komunën në monitorimin e plotësimin të sistemit të adresave në territorin e Komunës.

[Komuna]

1. Komuna kryen detyrat e saj sipas ligjit nr. 04/L-071 në Sistemin e Adresave;
2. Komuna do të caktojë një pikë qendrore lokale (zyrtar i planifikimit urban), i cili do të jetë përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve të departamenteve përkatëse komunale (si planifikimi urban, kadastra, taksat në pronë dhe shërbimet publike) për të siguruar një qasje të unifikuar për

përditësimin, mbajtjen, përdorimin e të dhënave të adresave dhe/ose sinjalizimin e emrave të rrugëve dhe/ose numrave të adresave, si dhe të jetë pika e kontaktit për komunikim me AKK-në dhe me Kompaninë;

3. Komuna do të caktojë një ekip me të paktën tre ekspertë, të cilët do të asistojnë dhe monitorojnë procesin e përditësimit, mirëmbajtjes, përdorimit të të dhënave të adresave dhe/ose sinjalizimit të emrave të rrugëve dhe/ose numrave të adresave. Anëtarët e ekipit duhet të jenë të pranishëm me kompaninë në terren gjatë vendosjes së tabelave. Ata janë përgjegjës për të treguar lokacionet e sakta për vendosjen e tabelave dhe për marrjen e miratimit të pronarëve të objekteve, nëse është e nevojshme, për vendosjen e tabelave në pronën e tyre;
4. Komuna do të pajtohet me kompaninë e kontraktuar për modalitetet praktike të bashkëpunimit, për të siguruar ekzekutim efikas të punës në terren. Pritet që përfaqësuesi i komunës të jetë i pranishëm për të punuar së bashku me kompaninë në terren gjatë orarit normal të punës, përveç nëse është rënë dakord ndryshe me kontraktorin.
5. Komuna siguron një vend për punë dhe pajisje të tjera të nevojshme (tavolinë, kompjuter, printer, materiale etj.) për stafin komunal të angazhuar për përditësimin, mirëmbajtjen, përdorimin e të dhënave të adresës;
6. Komuna siguron transport për stafin e angazhuar në projekt për kryerjen e detyrave të përcaktuara në terren;
7. Komuna inspekton procesin e mbledhjes dhe përditësimit të të dhënave të adresave në terren për pikat e adresave dhe adresat e brendshme;
8. Komuna do të sigurojë që të gjitha të dhënat përkatëse për rrugët që kanë emra dhe për hyrjet në ndërtesa dhe objekte të tjera që duhet të kenë një numër, të mblidhen dhe të vihen në dispozicion të Kompanisë sipas nevojës për planifikimin dhe implementimin e sinjalizimit;
9. Komuna, e mbështetur nga AKK, do të bëjë kontrollin e cilësisë së të dhënave të mbledhura;
10. Komuna, e asistuar nga AKK, do të digjitalizojë të dhënat e grumbulluara të adresave;
11. Komuna do të përditësojë dhe mirëmbajë të dhënat e adresave në ARIS sipas ligjit 04/L-071 për sistemin e adresave;
12. Komuna përgatit dhe printon hartat e nevojshme për punën në terren për mbledhjen e të dhënave, përditësimin e të dhënave, lidhjen e Gjendjes Civile me Regjistrin e Adresave dhe vendosjen e tabelave të emrave të rrugëve dhe numrave të shtëpive;
13. Komuna do të inspektojë procesin e përgjithshëm të sinjalizimit të emrave të rrugëve dhe numrave të adresave;
14. Komuna do të mirëmbajë tabelat e adresave (emrat e rrugëve dhe numrat e adresave) sipas ligjit 04/L-071 për sistemin e adresave;
15. Komuna ofron mbështetje për procesin e ndërlidhjes së Regjistrit Civil me Regjistrin e Adresave;
16. Komuna inspekton procesin e përgjithshëm të projektit të Përfundimit të Sistemit të Adresave;

17. Komuna do të përgatisë dhe shtypë letrat për t'i informuar qytetarët për adresën e re zyrtare dhe të sigurojë që letrat t'u shpërndahen qytetarëve dhe bizneseve;
18. Komuna do të heqë të gjitha tabelat e vjetra të emrave të rrugëve dhe tabelat e numrave të adresave, para se të vendosen tabelat e reja;
19. Komuna çdo muaj do t'i dërgojë AKK-së një raport të progresit duke informuar për ecurinë e projektit;
20. Komuna do të aprovojë të gjithë punën e bërë nga kompania e përzgjedhur para se të kryhen

Të gjitha palët do të kenë parasysh kufizimet kohore për kompletimin e Sistemit të Adresave.

Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi me nënshkrimin nga të gjitha palët dhe është plotësisht në fuqi që nga ajo datë. Ai do të mbetet i vlefshëm deri në ekzekutimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky mirëkuptim, përveç rastit kur ai përfundon më herët nga secila palë, duke i njoftuar palët e tjera jo më pak se një muaj me shkrim. Çdo modifikim i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit do t'i nënshtrohet miratimit me shkrim të palëve.

Nënshkruar më 30.09.2022 në Lipjan , në tri kopje në gjuhën shqipe dhe angleze.

Për Komunën e Lipjanit

Kryetar i Komunës

Z. Imri Ahmeti



Për Agjencinë Kadastrale të Kosovës

Zv. Drejtore e Përgjithshme

znj. Afërdita Thaçi

